



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 29.09.2023
NR.09/8248/2023

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës¹: 659-23-10270-1-4-7/C451 & KKHE(VM) 23-040-147

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

MESSER MEDICA L.L.C., 3 Kastriot rr.te Fabrika e Ujit, 15000, Obiliq me NUI.811452838, (në vazhdim "realizues i furnizimit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me bombola oksigjeni medicinal për nevoja të QKMF-së, me numër identifikues: 659-23-10270-1-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e relizuesit të furnizimit:

No.	Lot
1	Furnizim me bombola oksigjeni medicinal për nevoja të QKMF-së

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i furnizimit duhet të jetë: 795.00 €; Shtatëqind e nentdhjetë e pesë euro/00 cent] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të furnizimi, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për furnizuesin:

Për Autoritetin Kontraktues


KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Avdush BAJRAMALIU
Pozita:	Zyrtar i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	29.09.2023
Vula:	



Për realizuesin e furnizimit:

MESSER MEDICA L.L.C.

Emri:	Meriton Ilazi
Pozita:	Perfaqesues me autorizim
Nënshkrimi:	
Data:	29.09.2023
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-23-10270-1-4-7/C451

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Ferizaj dega ne Kaçanik.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të furnizimit është [29.09.2023].
	6.4	Data e Përfundimit është [29.11.2023].
	6.5	Vendi i kryerjes së furnizimit është [Qendra Kryesore e Mjekesis Familjare Hani i Elezit]
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është N/A
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është [0.25%] në ditë per furnizimie te parealizuara Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është [10%] të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: N/A
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë [shëno shumën] b) Përgjegjësia e Palës së Tretë [shëno shumën] c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve [shëno shumën] d) Përgjegjësia profesionale [shëno shumën] e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës [shëno shumën]
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: [Pagesa do te realizohet pas realizimit te furnizimit i pranuar nga AK. Artikujt duhet te jene konform specifickav te kerkuar nga AK-Komuna Hani i Elezit-dhe pagesa do te behet pas pranimit te furnizimi ne cilesi dhe sasi. Per ecurin e kesaj kontrate kudjeset Drejtorie e Shëndesisë dhe Mirëqenjes Sociale.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Furnizimi do te behet sipas pershkrimi te artikujve-tekl lista e çmi neve
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hani të Elezit ose permes procedurave alternative te zgjidhje se mosmarrveshjeve-procedurat e ndermjetesimit me pajtimin e te dy palve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [gjykata përkatëse në Ferizaj dega ne Kaçanik]. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].